

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA RANČELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATA E SHËNDRITJES / DATE OF ISSUANCE: 17.08.2020			
Instituti / Org. Jedin. Org. Unit	Shif. Klasif. Kodif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Dn. Prot. Prot. No.	Nr. Çështjes No. Page
04	47	1469	12



KOMUNA E MITROVICËS SË VERIUT OPŠTINA SEVERNA MITROVICA MUNICIPALITY OF MITROVICA NORTH	
Nr. Prot. Dn. Prot. Prot. No.	01 137/031
Nr. Çështjes No. Page	12 10.08.20

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government


Komuna e Mitrovicës së Veriut

Opština Severna Mitrovica

Municipality of Mitrovica North

Për Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga z. Aleksandar Spirović u.d. Kryetar I Komunës



**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE**

**të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra
Kombëtare e Auditimit**

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1	Të hyrat Çështja C1 - Mos zbatimi i ligjit dhe rregullave për tatim në pronë	Çështja e tatimit në paluajtshmeri është e rregulluar me Ligjin nr. 06/ L-005, për Tatimin në pronën e paluajtshme, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra për zbatimin e tij. Për zbatimin e këtij ligji, Komuna po has në pengesa dhe probleme. Komuna përkundër planifikimit më të lart të të hyrave nga tatimi në pronë (16,000€), krahasuar me vitin 2018 (8,700€) nuk kishte arritur që të inkasoj asnjë të hyrë nga tatimi në pronë. Po ashtu, Komuna nuk ka formuar shërbimin	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e Ligjit për Tatim në Pronë si dhe hartimin e një rregulloreje të brendshme për përcaktimin e shkallës së tarifave. Po ashtu, kryetari duhet të funksionalizojë shërbimin komunal për tatim në pronë, dhe që përmes komunikimit pro aktiv të ndikojë në ndërgjegjësimin	Në përputhje me mundësitë, kryetari i komunës do të përpiqet të zbatojë këtë rekomandim përmes Drejtorisë për Shërbime Publike, rëndësia e zbatimit do të promovohet	Personeli i angazhuar	Menjëher	Shërbimi komunal i tatimit në pronë nuk ekziston sepse komuna nuk ka vende punë ku mund të punësojë zyrtarë për të zbatuar Ligjin për taksën e pronës. Të ardhurat e planifikuara në pronë nuk janë realizuar për shkak të rrethanave

		<p>për tatim në pronë (nuk ka menaxher, nuk ka anketues, zyrtarë të trajnuar për përdorimin e sistemit protax etj), si dhe nuk kishte bërë seleksionimin e pasurive për të krijuar pastaj regjistrin e tatimit në pronë.</p> <p>Kuvendi komunal nuk ka nxjerrë asnjë rregullore për përcaktimin e shkallës tatimore.</p>	<p>e qytetarëve në lidhje me rëndësinë e tatimit në pronë dhe të dobive nga të cilat përfitojnë vet qytetarët.</p>	<p>het në mënyrë që qytetarët të ndërgjegjësohen për përfitimet që do të kenë.</p>			<p>përgjithshëm në veri</p>
2	<p>Të hyrat</p> <p>Çështja A1 - Mangësitë në tarifave të regjistrimit të automjeteve</p>	<p>Komuna nuk ka një infrastrukturë të qartë ligjore që rregullon mirë çështjen e mbledhjes së të ardhurave nga tarifave të regjistrimit të automjeteve për shkak të mosrespektimit të rregullores së brendshme me UA 07/2019 për regjistrimin e mjeteve motorike neni 5.</p> <p>Rregullorja komunale në bazë të së cilës është regjistruar mbledhja e të ardhurave nga tarifave të regjistrimit të automjeteve nuk parashikon ndonjë dokumentacion që mbledhet</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë funksionalitetin e kontrolleve në rast të mbledhjes dhe pagesën e obligimeve , duke përcaktuar në urdhëresën komunale provat ose dokumentacionin që është bashkangjitur për të verifikuar pagesën e rregullt.</p>	<p>Kryetari i komunës , në bashkëpunim me kuvendin , duhet do të propozojë hartimin e Rregullorës Komunale e cila do të verifikonte pagese rregullt.</p>	<p>Departamenti Ligjor, zyrtarët për të hyrat</p>	<p>Menjëher</p>	

		si provë për përcaktimin e shumës së tarifës bazuar në tonazhin e automjeteve motorike.					
3	Të hyrat Çështja A2 - Regjistrimi i dobët i të hyrave në E- kioskën	Në aparatin e ashtuquajtur E-kioskë, qytetarët përveç certifikatës së lindjes mund të nxjerrin edhe dokumente të tjera si - ekstraktin e lindjes, certifikatën e kurorëzimit, lajmërimin e vendbanimit, lajmërimin e bashkësinë e përbashkët familjare si dhe vërtetimin për detyrimet e pagesës së tatimit, duke paguar nga 1€. Gjatë vitit 2019 Komuna përmes këtij aparati komuna ka arkëtuar të hyra në shumë prej 1,236€. Edhe pse ishin lëshuar lloje të ndryshme të dokumenteve, të gjitha të hyrat ishin regjistruar në kodin 50013 (certifikata e lindjes). Gjithashtu, sipas Rregullës financiare 03/2010 për të hyrat vetanake, regjistrimi i tyre në SIMFK duhet të bëhet në baza ditore, derisa barazimet me Thesarin kryhen në baza mujore. Komuna nuk ka arrit të regjistroj me kohë të hyrat e	Kryetari duhet të rris shkallën e përgjegjësisë tek zyrtarët përkatës, në mënyrë që regjistrimi i të hyrave dhe raportimi i tyre të jetë i rregullt dhe me kohë. Po ashtu, duhet të sigurojë se të hyrat regjistrohen në kodet adekuate ekonomike në SIMFK.	Kryetari i komunës do të marrë masa për realizimin e rekomandimit	Departamenti për të hyrat	Menjëher	

		arkëtuar përmes E-kioskës dhe vonesat në regjistrimin e këtyre të hyrave në SIMFK kanë ndodhur për shkak të mos raportimit të rregullt.					
4	Pagat dhe mëditjet Çështja B1 – Sfidat në menaxhimin e personelit	Menaxhmenti ende nuk e ka miratuar rregulloren e brendshme për strukturën organizative, sistematizimin e vendeve të punës dhe për pajtueshmërinë e saj me nevojat dhe me buxhetin e Komunës. Kjo ka ndikuar që disa vende pune kyçe të mos plotësohen me staf apo të mbuloohen me kontrata mbi vepër.	Kryetari, duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprimet e duhura për t'i adresuar në mënyrë urgjente çështjet e përmendura më lart, ashtu që komuna të ketë të vendosur strukturën organizative dhe që vendet kyçe të punës të plotësohen me personelin adekuat për të evituar mbajtjen e punonjësve me kontrata mbi vepër.	Kryetari i komunës do të marrë masa për realizimin e rekomandimit	Menaxhmenti i komunës	Menjëher	
5	Pagat dhe mëditjet Çështja A3 – Mangësi në angazhime	Sipas nenit 12 pika 4 të LSHC Nr.03/L-149, emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura "Marrëveshje për	Kryetari duhet të sigurojë se angazhimi i stafit me MSHV bëhet vetëm për punë specifike dhe vetëm atëherë kur	Janë ndërmarr hapa. Është shpallur konkursi dhe janë plotësuar			Rekomandimi është realizuar

	<p>t me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta</p>	<p>shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit”. Angazhimet e tilla lejohen të bëhen vetëm për punë specifike dhe në kushte të veçanta e të paparashikuara. Komuna kishte angazhuar dy punonjës përmes MSHV-ve, për të cilët nuk ka zhvilluar procedurat e thjeshtësuar të rekrutimit. Në të dy rastet angazhimi i tyre ishte për pozita të rregullta (përkthyes dhe gjeodet) dhe ishte përtej afatit ligjor. Zyrtarja për përkthime ishte e angazhuar gjatë tërë vitit me MSHV7 deri në shpalljen e konkursit, konkurs ky i cili ishte filluar në muajin Shtator dhe është pezulluar me vendim të Qeverisë. E njëjta ka punuar deri në fund të vitit ndërsa komuna në vitin 2020 ka shpall këto dy pozita si të lira për rekrutim të rregullt. Gjithashtu edhe pozita e gjeodetit është mbuluar me marrëveshje përshërbim të veçanta gjatë gjithë vitit. Arsye e angazhimit në këtë</p>	<p>kërkesat janë nga njësit kërkuese. Dhe se, për angazhime të tilla të punëtorëve të aplikohet procedura e thjeshtësuar e rekrutimit.</p>	<p>vendet e lira të punës në mënyrë që askush të mos angazhohet me kontratë.</p>			
--	--	---	--	--	--	--	--

		mënyrë është se Ministria e Financave nuk e kishte lejuar rritjen e numrit të të punësuarve.					
6	Pagat dhe mëditjet Çështja A4 – Pagesa e faturave të pa specifikuar a	Pagesa e ujit është e rregulluar me Ligjin për ujërat 04/L-147, respektivisht me Udhëzimin plotësues Administrativ 02/2016 për Strukturën e pagesave të ujit. Ndërsa çështja e kërkesave të parashkuara është e rregulluar me Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve, neni 320. Komuna me dt. 20.06.2019 ka pranuar dhe protokolluar faturën e KRU „Mitrovica“ D.D. Në të njëjtën ditë komuna ka kryer pagesën në shumë prej 40,879.06€ në emër të Kompanisë regjionale të Ujësjetësit „Mitrovica“ D.D në lidhje me shpenzimin e ujit për periudhën e faturimit 06.2019-30.6.2013. Komuna këtë vlerë nuk e ka regjistruar si detyrim pasi që nuk kishte pranuar faturat për furnizim. Gjithashtu, përmbajtja e	Kryetari duhet të sigurojë që pagesat kryhen në bazë të faturave, përmbajtja e të cilave është në përputhje me rregullën financiare të SIMFK dhe Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve.	Kryetari i komunës do të marrë masa për realizimin e rekomandimit	Departamenti ligjor Drejtoria e Financave	Menjëher	

		faturës nuk përmban të dhëna qartë të specifikuara për konsumatorin8.					
7	Pagat dhe mëditjet Çështja A5 – Mbi pagesë për shpenzimet e telefonisë fikse	Në zbatim të Marrëveshjes ndërmjet Komunës dhe Telekom Kosovës - MPA për shërbime të telefonisë fikse, në emër të përdorimit të shërbimeve "Tik Centrex ISDN PRA" për vitin 2019, Komuna i ka paguar Telekomit 5,914.61€. Ne konstatuam se Komuna kishte paguar 3,154.73€ më shumë se shpenzimet reale. Sipas zyrtarëve të Komunës kjo kishte ndodhur për shkak të një gabimi teknik në platformën e faturimit të Telekomit, dhe se si rezultat i kësaj faturimi nuk ishte në përputhje me kontratën midis Telekom Kosova – MPA.	Kryetari duhet të sigurojë kontroll të shtuar mbi menaxhimin e kontratave me Telekom Kosova-MPA për shërbime të telefonisë fikse, si dhe kthimin e fondeve që kanë dëmtuar buxhetin komunal.	Kryetari i komunës do të marrë masa për realizimin e rekomandimit	Departamenti ligjor	Menjëher	
8	Subvencionet dhe transferet Çështja C2 – Pa rregullsi në raportimin e subvencion	Komuna me dt.11.11.2019 kishte hartuar rregulloren për mënyrën e dhënies dhe kriterëve të subvencionimit. Megjithatë, nga fillimi i vitit në mungesë të kësaj rregulloreje, të gjitha subvencionet pa kufizim të shumës janë miratuar me vendim të Kryetarit të	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e plotë të Rregullores për subvencione si dhe ti forcojë mekanizmat e mbikëqyrjes dhe menaxhimit të subvencioneve.	Kryetari i komunës do të marrë masa për realizimin e rekomandimit	Menaxhmenti i komunës departamenti i financave	Menjëher	

	eve	Komunës dhe Zëvendës Kryetarit. Gjithashtu, përfituesit e subvencioneve nuk kanë dorëzuar raporte kthyesë për mënyrën e shfrytëzimit të këtyre mjeteve.					
9	Subvencionet dhe transferet Çështja B2 –Niveli i ulët i realizimit të buxhetit	Realizimi i buxhetit final në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve ishte vetëm 10% ose 15,950€9. Këtë nivel shumë të ulët të realizimit të buxhetit e ka shkaktuar mungesa e rregullore së brendshme dhe qëllimeve të papërcaktuara në mënyrë të qartë për subvencionim, nga ana e Komunës.	Kryetari duhet të sigurojë që realizimi i buxhetit monitorohet vazhdimisht dhe sistematikisht mbi baza mujore dhe që ky rishikim identifikon dhe adreson pengesat dhe vështirësitë në realizimin e buxhetit në nivelin e planifikuar.	Kryetari i komunës do të marrë masa për realizimin e rekomandimit	Menjëher		Të ardhurat aktuale për vitin 2019 nuk u përdorën, gjë që ka rezultuar me një nivel të ulët të realizimit të buxhetit për subvencione.
10	Investimet kapitale Çështja C3 – Vonesa në realizimin e projekteve	Tek projekti "Ndërtimi i objektit të zjarrfikësve Faza II", me vlerën e kontraktuar prej 183,834€ (kontrata e nënshkruar më 10.12.2018) sipas planit dinamik është planifikuar që punimet të përfundojnë në afat prej 90 ditësh kalendarike. Vlera totale e punimeve të përfunduara për vitin 2019 është 93,071€. Zgjatja e afatit është kërkuar tri herë	Kryetari duhet të sigurojë që ndërmerren masa që vonesat e ngjashme nuk do të ndodhin në të ardhmen. Gjithashtu, menaxherët e kontratave duhet të përcjellin punimet ashtu siç janë të parapara në	Menaxherët e kontratave	Menjëher		

		nga OE, të gjitha kërkesat për shtyrje të afatit janë të aporvuara nga menaxhmenti i komunës. Këto vonesa janë shkaktuar nga kushtet atmosferike dhe nga vjedhja e instalimit elektrike të cilat kanë ndikuar në realizim të punëve.	kontratë dhe projekte.				
11	Pasuritë kapitale dhe jokapitale Çështja B3 - Regjistër jo i plotë i pasurive	Bazuar në Rregulloren MF-Nr.02/2013 nenin 2 "Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik, me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi". Komuna nuk ka arritur ti identifikojë të gjitha pasuritë komunale. Komisioni për regjistrimin e pasurisë e ka hartuar një listë të patundshmërive në emër të komunës, por ende nuk është përfunduar, sepse nuk janë përfshirë institucionet shkollore, shëndetësore dhe pasuritë tjera të	Kryetari duhet të sigurojë se do të kryhet një analizë me qëllim që të përcaktohen shkaqet kryesore të mos regjistrimit të pasurisë. Është e nevojshëm që të ndërmerren veprime specifike që shkaqet të adresohen në mënyre sistematike me qëllim që të eliminohen mangësitë në evidentimin dhe shpalosjen e drejtë dhe të vërtetë të pasurive.	Zyrtarë të çertifikuar të regjistrimit të pasurisë	Deri në njoftimin e rradhës		Ky proces nuk është në duart e vetëqeverisjes lokale, varet nga autoritetet nga niveli qendror.

		<p>patundshme. Kjo reflekton në regjistrin jo të plot të pasurive që komuna ka në posedim.</p> <p>Komuna kishte investuar për meremetimin e tyre, mirëpo vetëm shpenzimet e renovimeve i ka regjistruar si pasuri e jo objektin si tërësi. Kjo ka ndodhur për shkak se komuna ende nuk a ka përfunduar procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të tërësishëm të pasurive që ka në pronësi. Prandaj, nuk ka siguri në lidhje me vlerën e pasurive komunale të paraqitur në PFV për vitin 2019. Gjithashtu, Komuna nuk i ka regjistruar as investimet në vijim, të cilat financohen nga Fondi zhvillimor e as pajisjet e dhuruara nga KFOR-i (printerët).</p>					
12	<p>Auditimi i brendshëm</p> <p>Çështja B4 – Mos themelimi i Njësisë së Auditimit të</p>	<p>Neni 19 i Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, përcakton themelimin e funksionit të auditimit të brendshëm. Përkundër rekomandimeve tona të përsëritura, Komuna ende nuk ka arritur ti sigurojë</p>	<p>Kryetari duhet ta themelojë NjAB, me qëllim që të ofrojë mbështetje për menaxhimin e fushave me rrezik dhe për të ndihmuar në aktivitetet</p>	<p>Kryetari i komunës do të marrë masa për realizimin e rekomandimit</p>	<p>Zyrtarët e personelit</p>	<p>Menjëher</p>	<p>Gjatë vitit 2019 është shpall konkursi për pranimin e UR, por nuk është realizuar sepse ka aplikuar vetëm një kandidat</p>

	Brendshëm	shërbimet e auditimit të brendshëm dhe të njëjtat nuk janë mbuluar as nga ndonjë organizatë tjetër Kjo ndodhi sepse komuna nuk arriti të përfundojë konkursin për auditorin e brendshëm deri në fund të vitit 2019.	operative vijuese. Përveç kësaj, ne gjithashtu propozojmë themelimin/funksionimin e KA i cili do të shqyrtonte rezultatet e auditimit të brendshëm si dhe aktivitetet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.				
--	------------------	---	--	--	--	--	--